

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Zyra e Prindit, Familjes, Angazhimit të Komunitetit & Partnershipit me Organizatat me Bazë Fetare



Përgatitja për

PSSA

Manuali i

**Prindit për
suksesin e
Nxënësit**

ALBANIAN

PARENT UNIVERSITY



Parents Are Our Partners

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

Përgatitja për **PSSA**

Manuali i Prindit për suksesin e Nxënësit

Ky udhëzues është krijuar nga Zyra e Angazhimit të Prindit, Familjes, Komunitetit & Partnershipit me Organizatat Fetare- zyrë e cila koordinon nismat e prindërve dhe komunitetit me Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

Disa prej programeve dhe nismave të sponsorizuara nga zyra janë përfshijë:

- Universiteti i Prindit (shiko më pjesën mbra paqes së fundit për më shumë informacion)
- Qendra Burimore për Prindin dhe familjen;
- Programi Prindërit janë Partnerë të Barabartë (PREP);
- Këshilli Konsultativ i Prindërve sipas Tittle 1;

Zyra janë gjithashtu:

- Mbështet punën që bëhet në shkollë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe lidhjeve përmes asistentëve këshilltarë dygjuhësh;
- Ofron asistencë teknike dhe trajnim për Këshillat Konsultativë të Shkollave;
- Bashkëpunon me grupet e organizuara të prindërve, organizatat e komunitetit dhe ato me bazë fetare;
- Promovon angazhimet e prindërve dhe komunitetit në të gjithë Drejtorinë Arsimore;
- Ofron programe me pikësnyime dhe mbështet familjet shumëgjuhëshe.

Për më shumë dijeni rreth programeve dhe shërbimeve që ofrojmë, ju lutemi telefononi në 215-400-4180, ose na vizitoni në Qendrën Burimore të Prindit dhe Familjes në adresën 440 N. Broad Street, Philadelphia, PA 19130.

Në internet shkoni në uebsajtin e Drejtorisë: www.philasd.org dhe klikoni "Parent Engagement" linku në kutinë e gjelbër titullohet "PARENTS".

Studimet e shumta tregojnë, që angazhimi i prindit ka një efekt real dhe të prekshëm në suksesin e nxënësit. Kur prindi angazhohet në edukimin e fëmijës, ky merr nota më të mira, ka frekuentim më të mirë, vazhdon shkollimin më tej dhe është më i dhënë për të përfunduar studimet pas shkollës së mesme. Bota Akademike ofron sugjerimet e mëposhtëme në ndihmën që duhet ti japë fëmijës prindi i tij:

- Flisni me fëmijën çdo ditë për aktivitetet dhe eksperiencën në shkollë
- Qëndroni në kontakt me mësuesin e fëmijës edhe kur nuk ka probleme.
- Zgjeroni horizontin e fëmijës tuaj në kuptimin e botës që na rrethon duke vizituar dyqane, muzeume, parqe, universitete, stadione, teatër, ferma dhe vende në natyrë. Gjithmonë i diskutoni ato që keni parë gjatë vizitave.
- Bëjeni mësimin të lidhur me jetën e përditëshme: inkurajoni fëmijën të numërojë paratë; të bëjë listën e pazarit; të llogarisë koston, çmimin e shitjes dhe taksën; të lexojë menyte dhe gazetën; të shkruajë letra.
- Krijoni një vend dhe kohë të caktuar për detyrat e shtëpisë.
- Lexoni përditë diçka për fëmijën tuaj dhe e nxitni atë të lexojë në mënyrë të pavarur. Frekuentoni vazhdimisht bibliotekën
- Vizitoni sa më shpesh shkollën e fëmijës dhe angazhohuni në aktivitetet shkollore.
- Familjarizohuni me lëndët e fëmijës tuaj dhe kërkesat e synimet
- Bëni kujdes, se qëndrimi juaj ndaj shkollës dhe mësuesve, ndikon në qëndrimin e fëmijës.

Ne gjithashtu i inkurajojmë prindërit të jenë mbështetës dhe të mbajnë qëndrim pozitiv. Mësojinini fëmijës vetëbesimin dhe kujdesin për të tjerët. Kërkoni sa më shumë dhe ndihmoheni fëmijën që të arrijë këtë synim. Nëse diçka nuk shkon mirë, e rishikoni dhe e zgjidhni sëbashku. Ndhmoni fëmijën tuaj të bëhet elastik: përballimi i dështimit dhe mësimi nga ai është çelësi i suksesit.

Ndhimoheni fëmijën të dallojë fajin nga përgjegjësia. Faji bën që ne të shikojmë pas, pa mundur të ndryshojmë gjë; ai minon motivimin tonë dhe vetëbesimin. Përgjegjësia nënkupton pronësinë e rezultatit- kjo ndjenjë të çon përpara dhe krijon inisiativë dhe vetëbesim. Mos e bëni me faj fëmijën dhe e nxitni atë të marrë përgjegjësi për veprimet e tij.

KALENDARI I TESTIT PSSA PER VITIN SHKOLLOR 2011-2012

Testet e Vlerësimit	Datat	Klasat(s)
Ritestimi PSSA në Matematikë, Lexim, Shkencë dhe Shkrim për klasën e 12-të	24 Tetor – 4 Nëntor, 2011	12
Testi PSSA Matematikë dhe Lexim PSSA-M Matematikë PSSA-M Lexim	12 – 23 Mars, 2012	3 - 8, 11 4 - 8, 11 4 - 8, 11
Përfundimi i testit në Shkrim dhe Shkencë	26 – 30 Mars, 2012	Sipas nevojave
Testi PSSA Shkrim	16 – 20 Prill, 2012	5, 8, 11
Testi PSSA Shkencë Testi PSSA-M Shkencë	23 – 27 Prill, 2012	4, 8, 11 8, 11
Përfundimi i testit në Shkrim dhe Shkencë	30 Prill – 4 Maj, 2012	Sipas nevojave
Testi PASA në Matematikë dhe Lexim	13 Shkurt – 23 Mars, 2012	3 - 8, 11
Testi PASA Shkencë	1 – 25 Maj, 2012	4, 8, 11
Testi për ELL-ët	23 Janar – 2 Mars, 2012	K-12

Eshtë shumë e rëndësishme, që të gjithë nxënësit të jenë prezent në shkollë në datat e caktuara për testin e PSSA. Ju lutemi sigurohuni, që fëmija juaj të jetë në shkollë në këtë date, i çlodhur dhe i gatshëm për testim.

Përkthuesit e Vlerësimit të Nivelit të Performancës të shkollave të Pensilvanisë

Më poshtë janë vlerësime të përgjithëshme të përkthuesve të nivelit të performancës. Secili nivel klase dhe lënde ka përkthues të veçantë, të cilët mund të gjenden në uebsajtin e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë(PDE) <http://www.education.state.pa.us> (nga menuja majtas zgjidhni "Programs", "O to R", "Pennsylvania System of School Assessment", "Item and Scoring Samplers").

- **Nën nivelin Bazë** - rralë shfaq koncepte/aftësi që janë në nivelin e klasës, për një çështje/detyrë.
- **Niveli Bazë** - herë pas here shfaq koncepte/aftësi ,që janë në nivelin e klasës, për një çështje/detyrë.
- **Niveli i aftë** - vazhdimisht shfaq koncepte/aftësi ,që janë në nivelin e klasës, për një çështje/detyrë.
- **Niveli i Avancuar** - Në mënyrë të vazhdueshme shfaq kuptim të thellë të koncepteve/aftësive ,që janë në nivelin e klasës dhe përdor strategji të avancuara për të zgjidhur një detyrë.

Udhëzime të Vlefshme për Prindërit: Si të Ndhmoni Përmirësimin e Fëmijës Tuaj në

Mënyra më e mirë për të përmirësuar arritjet mësimore të fëmijës tuaj është të qënit mbështetës dhe të reflektoni një shikim pozitiv të rezultatit të testit dhe të shkollës në përgjithësi. Trajtimi negativisht mundet, që të tansmetohet te fëmija dhe të ndikojë pa dashje në rezultatet mësimore. Ka shumë mënyra që ju mund të ndihmoni fëmijën tuaj për të marrë rezultate të mira në testet standarde. Mbani mend, përgatitja për test është një proces i vazhdueshëm afat gjatë, që mund të bëhet me lehtësi pjesë e jetës tuaj të përditëshme.

Aktivitetet e përditëshme që ndihmojnë përgatitjen për test të fëmijës tuaj:

- Diskutoni bashkërisht rezultatet e fëmijës – pyeteni fëmijën “ Si kalove në shkollë?”
- Inkurajoni fëmijën të bëjë pyetje për gjërat të cilat ai ose ajo nuk i kupton - Asnjëherë të mos ngurrojë të pyesë!
- Tregoni interes në detyrat e shkollës dhe të shtëpisë, si dhe i kontrolloni për kryerjen e tyre. Detyrat e shtëpisë mund të jenë tregues të dobësive dhe që është koha për përmirësimin e tyre.
- Krijoni për fëmijën tuaj një mjedis sa më të përshtatshëm për studim.
- Komunikoni me mësuesin e fëmijës tuaj.
- Inkurajoni fëmijën tuaj në vendosjen e synimeve për rezultate të mira në shkollë. I mbështetni këto synime.



Udhëzime për Matematikën:

- **Diskutoni për punë të ndryshme, që përdorin matematikën.** Fëmijët pyesin shpesh, “ Pse duhet të studjoj algjebërën?” Ehtë e rëndësishme për ata të mësojnë, që matematika është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë të sejcilit. Ndërtuesit dhe konstruktorët përdorin ekuacione matematike që ndërtesat të ngrihen, shtrimi i karpetit ose parketit kërkon përdorimin e matematikës, për të përcaktuar sasinë e materialit që kërkohet. Arkëtari në dyqan përdor matematikën për të bërë llogaritë. Në këtë mënyrë ka shembuj të pafund në jetën e përditëshme, ku përdoren njohuritë matematikore.
- **Flisni për matematikën.** Ju do të habiteni se sa mundësi janë për të folur për këtë temë. Një shembull, në dyqanin ushqimor, pyesni fëmijën, cili artikull kushton më pak. Shumë dyqane aplikojnë ulje çmimesh me përqindje të caktuara. Pyeteni fëmijën se cili do të jetë çmimi i artikullit me uljen 30%.
- **Diskutoni paratë.** Shumë fëmijë marrin ulje çmimi. Nëse fëmija juaj ka një të tillë, pyeteni atë se sa do të jetë kjo ulje, nëse vitin tjetër do të jetë 5% më poshtë. Flitni me të rinjtë rreth mundësive për të kursyer para për kolegji, për një makinë, ose artikuj të tjerë që kushtojnë. Diskutoni për shpenzimet e përditëshme si qiraja, mortgixhi, shpenzimet për drita, gaz, ujë, ushqimet dhe rrobat. Fëmija mund të krijojë një listë dhe të diskutojë rrugët për të kursyer në sejcilën nga fushat e jetës së përditëshme.
- **Përgatitja e një ëmbëlsire.** Përgatitja e ëmbëlsirës, këkon koncepte matematike të tilla si matjet, volumi dhe koha. Fëmijët duhet të njohin matjen e përbërësve duke përdorur mjetet e matjes, përcaktimin e madhësisë së tavës, ku do të përgatitet ëmbëlsira dhe të përcaktojnë enën ku do t’i vendosin këto përbërës. Gjithashtu po kaq e rëndësishme është edhe koha, që kërkohet për të realizuar pjekjen!
- **Praktikoni përdorimin e kalkulatorit.** Shumë prej testeve standarde, përfshirë disa seksione të PSSA, lejojnë përdorimin e kalkulatorit. Inkurajoni fëmijën tuaj, që të praktikohet në përdorimin e tij përpara testit. ▶▶▶

Udhëzime të Vlefshme për Prindërit:

Si të Ndhmoni Përmirësimin e Fëmijës Tuaj në PSSA (vazhdim)

Udhëzime të tjera:

- **Udhëtimi me makinë.** Udhëtimet me makinë u japin mundësi të shkëlqyera fëmijëve për përmirësimin e aftësive në matematikë dhe lexim. Ajo çka është më e bukur, fëmija nuk e di se është duke mësuar dhe në këtë mënyrë koha kalon më shpejt. Thuaj fëmijës të shikojë dhe regjistrojë targat e makinave që ai shikon. Këto regjistrime mund të shërbejnë për të ndarë kategori të ndryshme të numrave, shteteve, krijojnë grafikë ose të dhëna të tjera të mundëshme. Gjatë udhëtimit mund të mësohen edhe shumë fjalë të reja. Stendat e afishimeve dhe shënjat sinjalizuese, shpesh japin një informacion të gjërë për fjalë të reja- punoni me fëmijët tuaj për shqiptimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve. Praktikisht çdo udhëtim i ri, pavarësisht nga distanca, ofron ide dhe objekte të reja, të cilat ndihmojnë për zgjerimi e fjalorit të tij, ose të saj.
- **Flashkartat.** Ka një shumicë flashkartash , të cilat mund t’i blini ose t’i përgatitni vetë. Mësuesi mund t’u ofrojë një listë të fjalëve të përshtatshme për moshën e fëmijës tuaj dhe e gjitha çka kërkohet nga ju, janë indeks karta të formatit 3” x 5”. Ju mund të përfshini terma të fjalorit matematik, të tilla si “treëndëshi- një figure me tre anë”, ose problemi matematik si “4 + 8 = 12”. Punoni me fëmijën dhe mësuesin e tij ose të saj, për përpilimin e një liste me fjalë ose problemesh matematike, që janë të vlefshme. Shikimi, shqiptimi dhe mësimi i fjalëve të reja, janë të rëndësishme për fëmijët e të gjitha moshave dhe klasave.

Udhëzime për lexim:

Kërkimet mbështesin faktin, që fëmijët të cilët lexojnë në shtëpi, arrijnë rezultate më të mira në shkollë. Leximi është një aftësi që mësohet- jo një aftësi e lindur.

- **Lexoni bashkërisht me fëmijën.** Kurrë nuk është shumë shpejt të filloni të lexoni bashkërisht dhe kurrë nuk mund të thuhet, që kam lexuar shumë. Leximi i ushqen fëmijët dhe zhvillon interesa në



gjuhë, fjalë dhe komunikim. Pavarësisht nga moshja e fëmijës, mbani në konsideratë leximin e një libri në muaj bashkërisht me të dhe e shfrytëzoni këtë si një pikënisje për bashkëbisedim. Bërja e këtij veprimi një rutinë, do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive për lexim të fëmijës.

- **Inkurajoni fëmijën tuaj të krijojë bibliotekën e tij.** Fëmijët duan të koleksionojnë lodra në formë kafshe, libra komikë, autografe dhe karta bejsbolli, pra pse mos t’i nxitim të koleksionojnë libra! Një bibliotekë personale do të krijojë një botë të tërë mundësishë. Nëse është e mundëshme, planifikoni një vizitë në librarinë lokale gjatë bërjes të pazarit.
- **I ofroni fëmijës revista, që lidhen me interesat e tij.** Sot ka revista që janë për të gjitha moshat dhe fushat e interesit. Fëmijët më të vegjël mund të fitojnë aftësitë e tyre bazë, nga revistat dhe ata më të rritur, mund të mësojnë për ngjarjet e ditës, si edhe të marrin informacione të tjera. Flisni me fëmijën tuaj rreth revistave dhe artikujve që ata lexojnë.
- **Vizitoni bibliotekën tuaj lokale.** Janë rreth 440 biblioteka publike në Pensilvani, të cilat kanë në përbërjen e personelit të tyre ekspertë në fushën e literaturës për fëmijë dhe që janë të gatshëm të ndihmojnë për titujt e librave dhe projekt ideve. Në të gjitha këto biblioteka, ju mund të merrni falas me afat të caktuar libra në shtëpi! ▶▶▶

Udhëzime të Vlefshme për Prindërit: Si të Ndhmoni Përmirësimin e Fëmijës Tuaj në PSSA (vazhdim)

Përgatitja për test:

- **Mësimi me ngut deri vonë natën përpara testit, nuk është rrugë efektive studimi** – studimi për testet duhet të bëhet ditë ose javë më përpara. Fëmija duhet të bëjë një rishikim të materialeve mbrëmjeve përpara testit. Bëni çdo gjë të mundshme, që fëmija të ushqehet dhe të pushojë mirë natën përpara testit. Fillojeni ditën e testit me një mëngjes të ushqyeshëm. Fëmijët që janë të lodhur janë më pak të përgatitur për përballimin e tendosjes së testit dhe mund të mos dalin mire në këtë test.
- **Mos shtoni stres në fëmijën tuaj.** Duke e vënë theksin më shumë seç duhet në rezultatet e testit, ai ose ajo mund të frikësohet për rezultatin e mundshëm dhe të stresohet kur të jetë në test- duke rritur mundësitë për gabime. Lehtësojeni stresin tuaj dhe të fëmijës, duke e parë këtë problem pozitivisht. Fëmija do të vërë re sensin optimist tuaj dhe do të rrisë besimin në vetvehte.

Pyetjet që hasen më shpesh

P: Çfarë është PSSA?

- PSSA është akronim për “Vlerësim i Sistemit Shkollor të Pensilvanisë” – një sistem vlerësimi që shtrihet në të gjithë shtetin, në lëndët e Matematikës, Leximit, Shkrimit dhe Shkencës, që realizohet çdo vit në Drejtoritë Arsimore të Pensilvanisë dhe shkollat Çartër, për matjen e arritjeve të Standardeve Mësimore të Pensilvanisë.

P: Cili është qëllimi i PSSA?

- Ofron për nxënësit, prindërit, edukatorët dhe qytetarët një panoramë për realizimet e nxënësve dhe performancën e shkollave.
- Përcakton shkallën me të cilat shkollat aftësojnë nxënësit për arritjen e standardeve 4 mësimore.

P: Kush merr pjesë në test?

Me përjashtim të pak nxënësve, të cilat cekin kriteret specifike për pjesëmarrje në teste alternative, të gjithë nxënësit janë të përfshirë si më poshtë:

- Lexim & Matematikë – Klasat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 11
- Shkrim ---Klasat 5, 8, dhe 11
- Shkencë—Klasat 4, 8, dhe 11

P: Sa kohë zgjat një testim?

- Testi i plotë për matematikën dhe leximin zgjat afërsisht gjashtë deri në shtatë orë. Testi për shkrimin arrin nga katër në gjashtë orë. Testi i shkencës kërkon nga dy në katër orë.
- Testimet normalisht shtrihen në afat disa ditor. Shkolla duhet t’ju informojë për datën e planifikuar të testit në shkollën tuaj.

P: Çfarë mund të bëjnë prindërit, që të sigurohen se fëmija i tyre është gati për ditën e testit?

- Shënoni në kalendar ditët e testeve, në mënyrë që ju dhe fëmija juaj të kujtoheni vazhdimisht për këto data.
- Sigurohuni që fëmija të mos mungojë ditët e testeve. Mos planifikoni në këto ditë asnjë vizitë tek doktori, dentisti apo diku gjatë.
- Mos ushtroni presion për rezultatin e testit, por inkurajoni qëndrimin serioz të fëmijës ndaj tij.
- Lejoni që fëmija të çlodhet disa orë përpara gjumit dhe sigurohuni që ai të flejë në mënyrë të mjaftueshme, natën përpara testit.
- Sigurohuni që fëmija të hajë ushqim të shëndetshëm dhe jo të rëndë, mëngjesin e testit.
- Inkurajoni fëmijën të dëgjojë me vëmendje udhëzimet e testit dhe të bëjë pyetje për paqartësitat.
- Qetësojeni fëmijën, duke e inkurajuar atë që të përpiqet të bëjë më të mirën e mundshme në test.

Udhëzime për Nxënësit në përgatitjen për test

- **Qëndroni në një hap me klasën në testet dhe detyrat e shtëpisë.** Puna në shkollë do t'ju ndihmojë për testet tuaja.
- **Flini në mënyrë të bollshme natën para testit.**
- **Hani mëngjes të shëndetshëm** ditën e testit.
- Merrni me vehte një libër, ose diçka tjetër në mënyrë që të lexoni në qetësi, n.q.s e mbaroni testin para kohe.
- Gjatë testit i **lexoni me kujdes udhëzimet.** N.q.s **nuk i kuptoni, kërkoni** nga mësuesi juaj që t'ua shpjegojë ato.
- **Pyetjeve të cilave nuk mund t'i jepni përgjigje, i kaloni dhe vazhdoni me pyetjet e tjera, këtyre pyetjeve ju riktheni më vonë.** Ju gjithashtu mund të hamëndësoni, duke eliminuar çdo përgjigje, për të cilat ju mendoni që nuk janë korrekte.
- Rilexoni pyetjet dhe përgjigjet. Rikthehuni tek teksti për përgjigjen e drejtë.
- **Lexoni çdo përgjigje të mundëshme përpara se të zgjidhni versionin tuaj përfundimtar.**
- **I kontrolloni përgjigjet, që të siguroheni se keni plotësuar katrorin e duhur.**
- Pas përfundimit të testit, i verifikoni të gjitha faqet, që të siguroheni se u jeni përgjigjur të gjitha pyetjeve.
- Pas përfundimit të testit, bëni diçka në qetësi. Mos harroni, se disa prej shokëve tuaj janë akoma duke punuar për testin.
- **Mos u shqetësoni! Bëni më të mirën e mundëshme.**

Strategjitë për Përgjigjet e Pyetjeve me Zgjedhje

- **Lexoni me kujdes çdo pyetje.** Mos mendoni që e dini përgjigjen, pa e kuptuar mirë çfarë kërkohet prej teje.
- **Secila pyetje me zgjedhje** (në çdo lëndë- Lexim, Matematikë, Shkrim ose Shkencë) ka vlerën e **një pike.**
- Nëse nuk e dini përgjigjen e një pyetjeje me zgjedhje, përdorni procesin e eliminimit si më poshtë.
- Nëse jeni i bllokuar me një pyetje, kalojeni atë dhe rikthehuni më vonë.
- **Gjeni kohë për plotësimin e të gjitha pyetjeve. Lënia pa përgjigje është e njëjtë si me një përgjigje të gabuar.**

Proçesi i Eliminimit- Ku të filloni, kur nuk jeni të sigurtë

Strategjia e eliminimit është një strategji e dobishme për përgjigjet e pyetjeve me zgjedhje.

Përpara se të shikojë përgjigjet e mundëshme, nxënësi duhet të hamendësojë se cila është përgjigja e drejtë. Kur kanë vështirësi për të bërë parashikim, ata mund të përdorin strategjinë e eliminimit të pyetjeve të gabuara.

Sa më shumë përgjigje eliminohen, aq më tepër rriten gjasat për përgjigjen e drejtë. Kjo tregon se si njohja me llojet e ndryshme të përgjigjeve të gabuara, të shënuara më poshtë, mund të ndihmojë nxënësit të përmirësojnë punën e tyre në teste.

Llojet e zgjedhjes së përgjigjes së gabuar përfshijnë:

- **Zgjedhjet me Përdorim të një Fjalori të Skajshëm.**

Eliminoni përgjigjet, që përdorin fjalor të skajshëm (kurrë, gjithmonë, aspak, të gjitha, më e mira dhe më e keqja), emocione të skajshme dhe reagime pasionante. ▶ ▶ ▶

• Zgjedhjet e Ngushta/Gjithëpërfshirëse

Disa zgjedhje u referohen një seksioni, jo të gjithë pjesës, ndërsa zgjedhjet e tjera mund të përfshijnë informacione, që janë shumë të përgjithshme. Eleminoni përgjigjet, që janë shumë gjithëpërfshirëse, ose shumë të ngushta.

• Të sakta, por Zgjedhjet

Disa zgjedhje përfshijnë informacion që është i saktë, por që nuk vlen për pyetjen e shtruar. Eleminoni zgjedhjet që janë të vërteta, por nuk i përgjigjen pyetjes së shtruar.

• Zgjedhjet Kontradiktore

Eleminoni zgjedhjet që kundërshtojnë pyetjen e shtruar. E zgjidhni këtë, vetëm nëse në pyetje është fjala "JO", ose "ME PERJASHTIM TE".

Testi i Leximit

- Testi i leximit adreson dy kategori të mëdha mjeshhtërisë, që përfshihen në procesin e gjuhës së shkruar: 1) Aftësitë në lexim dhe kuptimin e tekstit 2) aftësia e analizës dhe interpretimit të tekstit të lexuar.
- Gjatë testit të leximit, nxënësve u jepen një numër pjesësh letrare dhe nga letërsia artistike dhe u kërkohet t'u përgjigjen pyetjeve rreth këtyre pjesëve. Nga përgjigjet e dhëna, nxënësit shfaqin aftësitë e tyre në lexim dhe në kuptimin e pjesëve, si artistike dhe ato të zhanreve të tjera.

Pjesët e Leximit sipas Klasave

Pjesët e Leximit për Klasën e 3

- 2 Tregime
- 1 Poezi
- 1 tekst Informativ
- 1 Autobiografi/Biografi ose 1 Tekst Praktik/Udhëzim/Reklamë

Pjesët e Leximit për Klasën e 4-8 dhe 11

(kombinimet varen nga klasa)

- *Tregim (të gjitha klasat)
- *Poezi (të gjitha klasat)
- *Tekst Informativ+ (të gjitha klasat)
- *Autobiografi/Biografi (të gjitha klasat)
- Tekst Praktik/Udhëzim/Reklamë
- *Ese/Artikull (klasat 5, 6, 7, 8, dhe 11)

+ Teksti informativ mund të përfshijë një format faqe internet për klasat 6-8 dhe 11

Pyetjet me Shpjegim- Lexim

Nxënësve në testin e Leximit, të PSSA, për pjesën e përgjigjeve me shpjegim, u kërkohet të organizojnë përgjigjet e tyre në një mënyrë të shkurtër, të përmbledhur, të fokusuar, në kuptimin e teksteve (psh, përgjithësoni, identifikoni, shpjegoni dhe analizoni).

Mbani në kujtesë, që **testimi në lexim, NUK VLERESON aftësitë e nxënësve në të shkruajtur.**

Strategjitë për Përgjigjet e Pyetjeve me Shpjegim (Përgjigjet Krijuese)

- **Lexoni** pyetjet me përgjigje krijuese, ose pyetjet për "esetë", **përpara** se të filloni leximin e **pjesës letrare.**
- **Lexoni pyetjen me kujdes;** i kushtoni vëmendje të veçantë treguesve për t'u mbajtur mend.
- **Dalloni ose nënvizoni çështjet, të cilat ju kërkohet të bëni,** kërkesa si:
 - Shpjegoni idenë kryesore
 - Përshkruani karakterin
 - Përdorni 3 shëmbuj nga pjesa e lexuar
- **Mbani** përgjigjen krijuese të pjesës **gati në mëndjen tuaj,** ndërsa jeni duke lexuar.
- Gjatë leximit, **shënoni vëndet në pjesën letrare,** të cilat mund t'i përdorni në përgjigjet tuaja.
- **Përdorni fjalët të dhëna nga teksti, për krijimin e fjalive kryesore.**
- **Përgjigjuni të gjitha pjesëve të pyetjeve.**
- Përfshini **detaje nga pjesa e lexuar** në përgjigjet tuaja.
- Bëni një lidhje personale, duke përfshirë idetë tuaja.
- **Shkruani pastër dhe qartë.** Përdorni vetëm hapësirën, që ju lejohet.
- **Bindeni audiencën,** që ju e keni kuptuar pjesën e leximit.



STRATEGJIA PËR UDHËZIMET NË LEXIM

Rrethoni (theksoni) fjalët që tregojnë drejtim (foljet e veprimi).

Shembuj: *lexoj, shkruaj, rrjeshtoj, mbështes, justifikoj.*

Nënvizoni fjalët kyç, mbas fjalëve që tregojnë drejtim.

Fjalët kyç u përgjigjen pyetjeve: *si, çfarë, ku*

Numëroni sasinë e fjalëve që tregojnë drejtim (1, 2, 3)

Verifikoni çdo çështje ndërsa jeni duke e plotësuar. (✓)

SHEMBULL

1 ✓
2 ✓
3 ✓
Read the story. Explain the mood created by the author. Use examples from the story to show how the author creates the mood.



STRATEGJIA "TAG IT A 3" PËR PYETJET ME ZHVILLIM

Kthejeni pyetjen në një thënie (1)

Përgjigjuni pyetjes (2)

Jepni detaje, fakte dhe shëmbuj nga teksti për të mbështetur përgjigjen tuaj (3)

SHEMBULL

Jepni një fjalë ose frazë, që do të përshkruajë nxënësin, së bashku me përfaqësuesin e shkollës. Përdorni së paku një shembull nga çdo botim, që të shpjegojë përgjigjen tuaj.

Fjala që do të përdorni për të përshkruar nxënësin dhe shkollën duhet të jetë logjike.

Shembull i përdorimit të një fjale logjike është, kur ai thotë se celularët janë të nevojshëm për

sigurinë. Prindi ka nevojë të jetë në lidhje me fëmijën në raste urgjence.

Përfaqësuesi i shkollës është edhe ai në kuadrin logjik, kur thotë, që zëlja e celularit në klasë do të shkaktojë shqetësime, nga që fëmijët nuk i mbajnë të mbyllur ato.

ANALIZA

✓ Në përgjigje nxënësi përdor fjalë të tij, për të formuar fjalitë kryesore .

✓ Nxënësi ndjek saktësisht udhëzimet e dhëna në test.

✓ Nxënësi ofron shembuj e duhura nga teksti, për të ilustruar idetë e tij.

Udhëzues për Pikët e Përgjigjeve me Zhvillim të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë

3 Pikë

- Përgjigja është e plotë për pyetjen e shtruar, p.sh, një përgjigje që ofron korrektesën dhe mbështetjen e drejtë nga teksti.
- Përgjigja jep detajet e duhura specifike dhe të sakta (psh emërtimin, përshkrimin, shpjegimin ose krahasimin), ose shëmbujt.

2 Pikë

- Përgjigja është e pjesëshme për pyetjen e shtruar, p.sh, tregon disa njohuri për çështjen dhe së paku një detaj të marrë nga teksti.
- Përgjigja synon të japë detaje të mjaftueshme (p.sh, emërtimin, përshkrimin, shpjegimin ose krahasimin), ose shembuj; mund të përmbajë pasaktësi të vogla.

1 Pikë

- Përgjigja për pyetjen nuk është e plotë, p.sh tregon moskuptim të tekstit, ose nuk ofron detaje të marra nga teksti.
- Përgjigja nuk ofron detajet e duhura, ose shembuj që kanë ndikim në saktësinë.

0 Points

- Përgjigja nuk ka materialin e mjaftueshëm për t'u vlerësuar.
- Përgjigja është e pasaktë në të gjitha aspektet.

Testi i Matematikës

Çfarë kërkohet në Test?

Janë pesë kategori Matematike në testet e PSSA për klasat 3-8 dhe 11:

- ▶ A. Numrat dhe Veprimet
- ▶ B. Matjet
- ▶ C. Gjeometri
- ▶ D. Algjebër
- ▶ E. Analiza e të Dhënave dhe Statistika

Ju mund të gjeni shembuj të probleme dhe zgjidhjeve të tyre për të gjitha klasat në Artikuj Matematikore dhe Shembuj të Vlerësimeve. Ju lutemi referohuni në "Burimet në uebsajt për përgatitjet për Test" si më sipër, për udhëzimet hap pas hapi.

Strategjitë në Matematikë

Lexoni çdo pyetje me kujdes dhe përgjigjuni SAKTESISHT çfarë ju kërkohet.

RADHA E VEPRIMEVE

() Kllapat* (**ose simbole të tjera kllapash.Fillo veprimet brënda kllapave ()*)

Y^x Eksponentët

\times Shumëzimi } **
 $/$ Pjestimi } **

(**Pjestimi ose shumëzimi sipas radhës.)

$+$ Mbledhja } ***
 $-$ Zbritja } ***

(***Mbledhja ose zbritja sipas radhës.)



PERTHYERJA E KODIT MATEMATIKOR

Përdorni Fjalorin si ndihmë, që të Vendosni çfarë Veprimi të Përdorni

MBLEDHJA (ADDITION)	ZBRITJA (SUBTRACTION)
add	are not
altogether	change
and	decreased by
both	difference
how many	fewer
how much	have left
in all	how many didn't
increased by	how many more
more	how much more
plus	less than
sum	remains
together	subtract
total	take away
PJESTIMI (DIVISION)	MULTIPLICATION
cut into	taller/shorter
divided by	altogether
each group has	by
half / equal parts	double
quotient of	each
separated	multiplied by
share equally	product of
split	times

Teknika për Zgjidhjen e Problemeve Matematikore

- Kuptojeni problemin, përfytyrojeni ,ose përdorni objekte
- Vizatoni një pamje, ose diagramë
- Krijoni një tabelë ose grafik
- Hartoni një listë
- Bëni një hamendësim dhe plotësojeni
- Kthehuni në pyetjet e lëna pa përgjigje.
- Shiko për një model të mundshëm.
- Thjeshtojeni
- Jepni ide

Pyetjet me Zhvillim –Matematikë

Shembuj se si mund të formulohen çeshtjet në pyetjet me zhvillim:

- Tregoni, ose shpjegoni punën e kryer
- Tregoni të gjithë punën e kryer. Shpjegoni çdo shkallë të veprimeve të kryera.
- Shpjegoni pse diçka është e vërtetë, ose e gabuar
- Përshkruani ndikimin e veprimeve në gjërat e tjera.
- Përshkruani si do të zgjidhni një problem



Strategjia

MATEMATIKE ME DY KOLONA për përgjigjet e pyetjeve me zhvillim

1. Lexojeni problemin
2. Ndajeni fletën në dy kolona
 - ▶ Emërtoni kolonën majtas “Kërkesa” (Work)
 - ▶ Emërtoni kolonën djathtas “Shpjegim” (Explanation)
3. Numëroni çdo shkallë të kolonës “kërkesa” dhe të shpjegimit korespondues
4. Kryeni veprimet gjatë gjithë faqes
 - ▶ Punoni në pikën e parë, shkruani shpjegimin.
 - ▶ Punoni në pikën e mëtejshme e kështu me radhë.
5. Shmangni përdorimin e numrave në kolonën e shpjegimeve
6. Shkruani përgjigjen

Adapted by Jeffery Kodroff © 2003

Udhëzues i përgjithshëm për Pikët e Përgjigjeve me Zhvillim të PDE në Matematikë

4 Pikë

Përgjigja demonstroi një kuptim të gjithanshëm të koncepteve matematike dhe procedurave që kërkon pyetja.

- Përgjigja është korrekte, me procedura të plota e të qarta, shfaq shpjegim korrekt, sipas kërkesave të pyetjes. Përgjigja mund të ketë një “cen” të vogël (psh, mungon shenja \$), ose mungesë që nuk prish kuptimin e përgjithshëm.

3 Pikë

Përgjigja demonstroi një kuptim të përgjithshëm të koncepteve matematike dhe procedurave që kërkon pyetja.

- Përgjigja dhe shpjegimi, siç kërkohet nga pyetja, është kryesisht e plotë dhe korrekte. Përgjigja mund të ketë gabime të vogla, ose mungesa, të cilat nuk zvogëlojnë demonstrimin e kuptimit të përgjithshëm.

2 Pikë

Përgjigja demonstroi një kuptim të pjesshëm të koncepteve matematike dhe procedurave të kërkuara nga pyetja.

- Pyetja është disi e saktë, me kuptim të pjesshëm të koncepteve të kërkuara matematike dhe/ose procedurave të demonstruara dhe/ose shpjegimeve. Përgjigja përmban një punë të bërë disi, por të papërfunduar ose të paqartë.

1 Pikë

